

  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

Nr. 56, dt. 02.04. 2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 02.04.2015, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratohen projektet e restaurimit të TIKA-s me këto vërejtje:

*Të mos ndryshojë konstruksioni dhe materiali i çative për të katër objektet.*

*Restaurimi duhet të marrë parasysh ruajtjen e strukturave origjinale të çative ekzistuese duke zëvendësuar vetëm elementët e dëmtuar të konstruksionit të saj si dhe të zëvendësohen vetëm tjetegullat e dëmtuara të çative me tjetegulla vendi me të njëjtat karakteristika si origjinalitet. Të detajohen grafikisht strukturat e përkohshme të mbulimit për secilin objekt. Materiali grafik i rilevimit të objekteve në format dëg të depozitohet pranë IMK.*

- *Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia e Beqarëve”, Berat, sugjerohet:*

*Të hiqen kangjellat metalike të dritareve me harqe.*

- *Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia Mbret”, Berat:*

*Të bëhet sistemimi i sheshit të oborrit me kalldrëm në hapësirën ku aktualisht ndodhet një lulishte.*

*TIKA duhet të procedojë tek Agjencia e Shërbimit Arkeologjik lidhur me gërmimet që parashikohen të bëhen në këtë shesh.*

- *Lidhur me projekt restaurimin “Teqeja e Helveticë”, Berat.*

*Të ndërohen vetëm elementet që janë të dëmtuara.*

- *Lidhur me projekt restaurimin “Xhamia e Et’hem Beut”, Tiranë.*

*Të mos hiqen vetratat e dritareve të hajatit, por të respektohet vendimi i mëparshëm i KKR.*

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, nr. 76, Kinostudio, Tiranë, Shqipëri,

Tel. 04 4504153; 04 4504152

Email: info@imk.gov.al